



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL BERAT
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Berat, më / / 2022.

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje paisje mjekësore për Bankën e Gjakut”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Paisje biomjekësore-38434540-3; Inkubatore-33152000-0; Frigorifere-39711130-9

VLERA E FONDIT LIMIT:

2.Fondi limit (në total për të gjitha lotet): 11926033

(Njembdhjetemilioneqindendjeteegjashtemijetridhjeteetre) lekë pa TVSH.

- Perlllogaritja e fondit limit është dokumentuar nga komisioni i argumentimit të perlllogaritjes së fondit limit të procedurës me Nr. 3018 Prot. Date 09.08.2022.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Berat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi:Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit dhe kërkesat e pikës 1 (gërmat a / b) të kritereve të veçanta të kualifikimit janë parashikuar pa ndryshime, sipas formatit të dokumenteve standarde të tenderit të publikuara nga APP, dhe vendosja e tyre është bazuar në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për tregtim te pajisjeve mjekësore.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të percaktuar se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, Gjithashtu ky kriter është bazuar dhe në nenin 21, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.*

- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” sipas konformitetit me standartet europiane- e vlefshme, dhe nëse

operatori ekonomik ofertues është prodhues i pajisjeve mjekesore duhet të paraqesë **certifikatën SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilesise per Paisjet Mjekesore”, ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilesise per Paisjet Mjekesore” me objekt aktiviteti të certifikates per tregetim të materialeve/paisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

c) Operatori ekonomik ofertues në rastet **kur nuk është prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet të paraqesë autodeklarate** që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është konform standarteve të cilesise **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” sipas konformitetit me standartet europiane- e vlefshme ose duhet të paraqesë certifikatën **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilesise per Paisjet Mjekesore”, ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilesise per Paisjet Mjekesore” me objekt aktiviteti të certifikates per tregetim të materialeve/paisjeve mjekësore në përputhje me në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vleresimit të dokumentacionit dhe në rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet të paraqesë certifikatën në fjale.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, kriteri i sipërpermendur plotësohet nga të gjithë operatorët ekonomik se bashku.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga RSH.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 79/1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1,3,4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjisllacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se se mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertues vetë paraqesin çertifikata të lëshuara në përputhje me objektin e prokurimit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma nderkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për cilësinë e produkteve që do të furnizojnë dhe garancinë e tyre sipas normativave standarte.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1-Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim për xhiron vjetore për tre vitet financiare 2019,2020,2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kerkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë

pjesemarres te mundshem si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave

2.3 Kapaciteti teknik:

1-Dëshmi nga Operatori Ekonomik për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

-Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara me një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 4 te nent 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ne te cilen gjejme te percaktuar se : pika 4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që*

operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 ne te cilen eshte percaktuar: pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ne te cilen eshte percaktuar: pika 4 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për aftësinë e tyre teknike nepermjet përvojave të duhura që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit për zbatimin e kontratës. Për këtë është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2-Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e vet të pakten 1 (një) Ing. Biomedical ose informatik ose elektronik ose elektrik ose fusha të ngjashme të certifikuar ose trajnuar për instalimin dhe servis pajisjesh mjekësore objekt prokurimi, të vërtetuar me diplomën perkatese, certifikatën e trajnimit, CV-ne, kontratën individuale të vlefshme të punës në ditën e hapjes së ofertave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij një Ing. biomedical/informatik/elektronik/elektrik ose fusha të ngjashme të certifikuar/trajnuar për instalimin dhe servis pajisjesh mjekësore objekt prokurimi është vendosur në funksion të realizimit të kontratës.

3-Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (***pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen***). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (***te markuara sipas artikullit***) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumenti: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në nenin 40, pika 6) germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë duhet të demonstrojnë nepermjet katalogeve të aparaturave/pajisjeve që ofrojnë, specifikimet teknike konkrete, të markuara. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Specifikimet teknike të aparaturave/pajisjeve të markuara shërbejnë si baze vlerësimi nga KVO gjatë shqyrtimit të ofertave teknike të OE aparaturave/pajisjeve

4-Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një autodeklarate ku deklaron se pajisjet do të jenë të shoqeruara me manualin e përdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualin e servisit/shërbimit.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës.

5-Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjet/artikujt e kërkuar bashkë me aksesoret përkatëse në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet përkatëse për produktet.

Argumentimi: kërkesat e kesaj pike lidhen me verifikimet e mëtejshme që kanë të bëjnë me marrjen në dorezim të mallit (për OE fitues) nga AK. Të gjitha kërkesat e kesaj pike, përfshi dhe çertifikimet, janë kërkesa që duhet të shoqërojnë aparaturat/pajisjet mjekësore.

Ky kriter është vendosur në përputhje me **pikën 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”**, në të cilin është e përcaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohen.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë I nevojshëm transferimi I të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuar plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësitë kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu ky kriter është në përputhje me pikën 2 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *Pika 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, nëpërputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që I vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Autoritti Kontraktor nepermjet ofertes teknike, do te bej te mundur verifikimin me te sakte te artikullit te ofertuar, specifikimeve te tij, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbeshtetes te paraqitur nga ofertuesi.

Ky kriter vendoset me qellim njohjen e origjines se mallit dhe kompanin prodhuese per identifikimin ne menyre te qarte gjate levrimit te tij dhe per te pasur siguri qe i njeiti mall i ofruar do te levrohet ne destinacion ne perputhje me nenin 40 pika 6 dhe 8 te vkm 285 date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”. Keto kerkesa i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise se operatorik ekonomik per permbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi.

6- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **Autorizim nga firma prodhuese / MAH / ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, (ku te provohet / dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin)** nepermjet te cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet te tregetoje pajisjet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave, origjinal ose fotokopje e noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: Pika 5. *”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

7-Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autodeklarate për pajisjet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformitetin me normat MDD ose MDR 93/42/EEC (të përditësuar) ose 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur eshte e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e dorezimit te ofertave.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar iakreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga institucionet e autorizuara që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE I këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” (nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit”.

8- Operatori ekonomik duhet te paraqese deklaraten e garancise me periudhe 1(nje) **vit garanci nga data e furnizimit** per pajisjet dhe aksesoret shoqerues, **perfshirë blerjen dhe zevendesimin e pjeseve te difektuara me pjese kembimi te reja dhe origjinale.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund te hartojë kriteret ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates, si dhe pika 8 e po ketij neni ne te cilen eshte percaktuar : Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktojë kriteret te vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet, te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates*

9- Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate per furnizimet me pajisjet mjekesore te kerkuara sipas afatit te percaktuar.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.

10- Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku te konfirmoj venien ne pune te pajisjeve mjekesore te kerkuara.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.

11- Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate paraprake per garantimin e rregjistrimit te pajisjeve mjekesore te kerkuara te AKBPM-ja, pas shpalljes fitues sipas ligjit 89/2014 “per pajisjet mjekesore”.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në baze të nenit 29 të ligjit 89/2014 "Për paisjet mjekesore" me ndryshimet në ligjin 21/2020 datë 05.03.2020. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës.

12- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku deklaron se pajisjet mjekesore janë vendosur dhe ambalazhuar sipas standartit të prodhuesit, pajisjet të jenë të reja, të përdorura dhe modeli të jetë I 2(dy) viteve të fundit".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund të hartojë kritere në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe pika 8 e po këtij neni në të cilën është përcaktuar : Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen ,mund të përcaktojë kritere të vecanta në varësi të objektit që prokurohet ,të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*

Per sa i përket kërkesës ... modeli të jetë I 2(dy) viteve të fundit, AK argumenton këtë kërkesë bazuar në kërkesën e Shërbimit të Bankës së Gjakut, për objektin që prokurohet, duke qenë se ky shërbim ka rëndësi jetike dhe me këto pajisje të teknologjive të fundit do të arrihet rritja e cilësisë, garancisë së këtij shërbimi dhe ulje të kostove gjatë funksionimit të tyre.

13- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku deklaron se merr përsipër trajnimin e stafit mjekësor për përdorimin e pajisjeve në momentin e dorëzimit të tyre.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI LIGJOR DHE TEKNIK I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike të mësipërme janë hartuar në bazë të nenit 21, pika 2, nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (në vijim "VKM"), Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr	Artikulli	Njesia	Sasia
1	HB Meter	cope	1
2	Fishakyveta per HB meter	cope	2000
3	Shtrat per dhuringjaku	cope	2
4	Biomikser (perzjeresdhepeshore per produktin)	cope	3
5	Perzieres portativ per sesionlevizes	cope	3
6	Frigoriferngrires -45grade	cope	1
7	Ngjites(sealer)	cope	2
8	Peshore per ndarjegjaku	cope	2
9	Ekstraktor manual per komponentegjaku	cope	2
10	Centrifuge per kampionegjaku (me 8-12 vende)	cope	1
11	InkubatorGjaku	cope	1
12	Shpelareshgjaku	cope	1
13	Shtreter portativ per sesionlevizes	cope	3
14	Frigorifere per ruajtjen e gjakut +4 deri +6 grade	cope	2
15	Frigoriferushqimor	cope	1
16	Termus per transport gjaku	cope	3
17	Peshore per dhuruesit	cope	2

NR	Artikulli	Specifikime Teknike	Sasia
1	HB Meter	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aparati te jete I pershtatshem per analizen e hemoglobines totale, i lehte ne peshe dhe per tu perdorur. 2. Te jete e pajisur me bateri per matje mbi 100 ore ne menyre te vazhdueshme 3. Diapazoni I matjes 0-25.6 g/dL 4. Lineariteti: 0-20g/dL: +/- 0.3g/dL 4. Te kryeje matjen me sasi jo me madhe se 8uL 5. Koha e matjes te mos jete me shume se 60 sek 6. Metoda e matjes: fotometrike 7. Aparati te punoje me mikrokyveta pa reagent 8. Mikrokyveta te jete lehtesisht e perdorshme dhe te marre gjakun ne cdo kend 9. Sistemi optic te jete I kalibruar nga fabrika sipas standarteve NCCLS dhe te mos kete nevoje per mirmbajtje periodike 10. Mikrokyvetat te kene jetegjatesi jo me pak se 12 muaj nga koha e marrjes ne dorezim. 11. Pajisja te kryeje autokontroll ne menyre automatike 12. Te kete nderfaqe grafike ne ekran per te treguar hap pas hapi instruksionet ne perdorim 13. Mundesi lidhjeje me kompjuter nepermjet portave USB 14. Te ruaje rezultatet ne memorien e brendshme deri ne 4000 rezultate. 15. Mundesi identifikimi I pacienteve, operatorit, lotit te kyvetave nepermjet barkodeve. 	1
2	Fisha kyveta per HB meter	Mikrokyveta te pershtashme per HB metrin e ofruar me sasi jo me te madhe se 8uL gjak	2000

3	Shtrat per dhurim gjaku	<p>Krevat manual I pershtatshem per dhurimin e gjakut</p> <p>Rregullime manuale të mbështetëses së kokës dhe këmbës</p> <p>Krevati dhe mbështetëset e krahëve me mbulesë vinylex, lehtësisht e pastrueshme</p> <p>Stativi IV i lëvizshem, teleskopike</p>	2
4	Biomikser (perzjeres dhe peshore per produktin)	<p>(Aparat per perzierjen dhe peshimin e gjakut gjate dhurimit).</p> <p>Mixeri duhet te kete tiparet e meposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Te ofroje nje peshe me precizion me te vogel se 1%, me variacion jo me shume se $\pm 3g$ per 0-500 gr 2. Te jete i pajisur me kleme per bllokim automatik te dhurimit me plotesimin e peshes/volumit target (sipas rregulloreve ne fuqi). 3. Te siguroje perzierjen e vazhdueshme me antikoagulantin nepermjet tundjes se gjithë perberjes ne qesen e gjakut, gjate kohes se dhurimit. 4. Te kete timer per arritjen e kohes maksimale te dhurimit qe nevojitet per prodhimin cilesor te komponenteve dhe te aktivizojë alarmin nese koha e programuar per kete qellim, tejkalohe. 5. Te bej kontrollin e rrjedhes se gjakut, me alarm si per rrjedhjen e larte, ashtu dhe per ate te ulet. 6. Te jete i pajisur me barcode reader. 7. Te ofroje mundesine e kontrollit paralel te te dhenave (konfirmim te ID se dhuruesit, me ate te qeses dhe te tubave), si dhe te ruaje cdo informacion ne nje data-base te vet. 8. Te ruaje me shume informacion te jashtem te dhene nepermjet bar-codeve (lotin e qeses, skadencen, ID e dhuruesit, ID e operatorit, ID e tubave). 9. Mundesi per te vendosur deri ne 4 programe te ndryshme te sasise se marre gjate dhurimit. 10. Te jete i pajisur me ekran me ngjyra me prekje ne te cilen te shfaqen te dhenat si koha e fillimit, koha e mbetur, sasia e marre dhe nderfaqja per vendosjen e rregullt te qeses sipas etapave. 11. Te jete i pajisur me bateri me fuqi te larte. 	3
5	Perzieres portativ per sesion levizes	<p>(Aparat per perzierjen dhe peshimin e gjakut gjate dhurimit).</p> <p>Mixeri duhet te kete tiparet e meposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Te ofroje nje peshe me precizion me te vogel se 1%, me variacion jo me shume se $\pm 3g$ per 0-500 gr 2. Te jete i pajisur me kleme per bllokim automatik te dhurimit me plotesimin e peshes/volumit target (sipas rregulloreve ne fuqi). 3. Te siguroje perzierjen e vazhdueshme me antikoagulantin nepermjet tundjes se gjithë perberjes ne qesen e gjakut, gjate kohes se dhurimit. 4. Te kete timer per arritjen e kohes maksimale te dhurimit qe nevojitet per prodhimin cilesor te komponenteve dhe te aktivizojë alarmin nese koha e programuar per kete qellim, tejkalohe. 5. Te bej kontrollin e rrjedhes se gjakut, me alarm si per rrjedhjen e larte, ashtu dhe per ate te ulet. 6. Te jete i pajisur me barcode reader. 7. Te ofroje mundesine e kontrollit paralel te te dhenave (konfirmim te ID se dhuruesit, me ate te qeses dhe te tubave), si dhe te ruaje cdo informacion ne nje 	3

		<p>data-base te vet.</p> <p>8. Te ruaje me shume informacion te jashtem te dhene nepermjet bar-codeve (lotin e qeses, skadencen, ID e dhuruesit, ID e operatorit, ID e tubave).</p> <p>9. Mundesi per te vendosur deri ne 4 programe te ndryshme te sasise se marre gjate dhurimit. 10. Te jete i pajisur me ekran me ngjyra me prekje ne te cilen te shfaqen te dhenat si koha e fillimit, koha e mbetur, sasia e marre dhe nderfaqja per vendosjen e rregullt te qeses sipas etapave.</p> <p>11. Te jete i pajisur me kase transporti me porta karikimi te integruara per perdorim ne terren nepermjet baterise se brendshme.</p> <p>12. Te jete i pajisur me bateri me fuqi te larte.</p>	
6	<p>Frigorifer ngrires - 45grade</p>	<p>Frigorifere -30- -60°C për ruajtjen e gjakut</p> <ul style="list-style-type: none"> - Frigorifer horizontal me strukture celiku Brenda dhe jashte. I lehte per tu pastruar dhe per perdorim spitalor. - Izolimi te jete te pakten 80mm - Temperatura: -30°C - -60°C - Kapaciteti I brendshem: jo me pak se 130 litra - Kontrolli I temperatures opsional me grafik. - Te jete I pajisur me 4 rrota. - Te kete mundesi te kycjes se deres per persona te pa autorizuar. - Te jete I pajisur me alarm ne rast te mosfunktionimit te sondes se temperatures - Te jete I pajisur me alarm per temperaturen maksimale dhe minimale - Te kete afishim te temperatures aktuale. - Te kete sistem alarmi visual dhe zanor - Gazi i perdorur CFC-free - Burimi i ushqimit: 220-240V / 50Hz 	1
7	<p>Ngjites (sealer)</p>	<p>Ngjitësat shërbejnë për ngjitjen me nxehtësi të tubave plastike te qeses së gjakut. Qëllimi është të garantojë kushtet aseptike të përmbajtjes brenda qeses. Kjo pajisje duhet të plotësojë këto kritere:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Kompakt, i lehtë dhe jo i zhurmshëm gjatë përdorimit. 2) Te siguroje detektim optik te tubit, 3) Te jete i dizenuar per te bere ngjitje tubash te njome e te thate. 4) Drite sinjalizuese led per gjendjen e ngjitesit 5) Drite sinjalizuese led ne rast mosfunktionimi te ngjitesit 6) Të sigurojë ngjitje të shpejta në seri dhe hermetike, duke minimizuar kontaminimin bakterial dhe hemolizën e gjakut dhe produkteve të tij, per kete arsye trashesia e pajisjes te mos jete me shume se 7 cm per pregatitjen e segmentimit te shpejte te tubit. 7) Koka metalike e ngjitesit te jete e lehtë për tu hequr dhe per tu pastruar. 8) Per ngjitje te tubave PVC deri ne 6 mm 9) Koha e ngjitjes jo me shume se 3 sekonda 10) Te kete porta komunikimi COM In dhe COM OUT per lidhje ne seri. 11) Ushqimi duhet te jete 220-230V, 50-60Hz 	2

8	Peshore per ndarje gjaku	<p>1- Peshore e pershtatshme per peshimin e qeseve te gjakut 2- Diapazoni nga 1 deri ne 3000 gram 3- Lineariteti 0.3 gram 4- Leximi 0,1 gram 5- E pajisur me ekran LCD 6- Funkison per fikje automatike 7- Porta dalese USB dhe RS232C per lidhje me pajisje periferike 8- Te kete funksion lidhjeje me skanues barkodi dhe printeri 9- Te jete e pajisur me softëare per lidhjen me kompjuterin. 10- Burimi I ushqimit 220-240V/ 50Hz</p>	2
9	Ekstraktor manual per komponente gjaku	<p>Sistem manual per ekstraktimin e komponenteve te gjakut. I pershtatshem per qese 100 ml, 200ml, 300ml, 400ml.</p>	2
10	Centrifuge per kampione gjaku (me 8-12 vende)	<p>RCF maksimale: te pakten 3400 RPM maksimale: te pakten 6000 /min Kapaciteti maksimal: te pakten 8 x 15ml Koha e punes: 1-99 minuta, pune e vazhdueshme, cikle te shkurtra Mbyllje e kapakut metalik me nje dore Me ekran qe tregon vlerat aktuale Motorr pa karboncina (brushless) Mundesit hapje te bllokuesit te kapakut ne rast emergjence EN / IEC 61326-1, class B Niveli i zhurmes: jo me shume se 50 dB Te shoqerohet me 40 cope tuba 15ml</p>	1
11	Inkubator Gjaku	<p>Tensioni $230 \pm 10\% V$, Konsumi i energjisë maksimale 500 Ë Gama e temperaturës së dhomës $22 \text{ }^\circ\text{C} \pm 2 \text{ }^\circ\text{C}$ Kapaciteti 24 qese trombocite 100 mL Siguria elektrike: Mbrojtja nga goditja elektrike - Klasa I Operacioni i vazhdueshëm Tundesit i perfshire per kapacitet 24 qese 100 ml Cikle per minute: 65 +-7 Mekanizmi i tundesit: I kontrolluar nga nje elektromotor 230V AC Kabineti i jashtëm Çelik i veshur Tipi i tundesit: levizje horizontale Dhoma e brendshme Çelik inox Metoda e ftohjes: termoelektrike Izolimi: Izolim poliuretani (PU) pa klorofluorkarbon (CFC) Ekрани LED Intervali i shfaqjes së temperaturës 0,5 °C Regjistrimi i temperaturës: Stilolaps boje në grafik letre, javore Saktësia e sensorit të temperaturës $\pm 0,5 \text{ }^\circ\text{C}$ Gama e grafikut 0 °C deri në 40 °C</p>	1

		<p>Intervali i grafikut 1 °C</p> <p>Llamba 4 Ë tub LED</p> <p>Hyrja e vlerësimit të mbrojtjes nga uji IPX-0</p> <p>Temperatura e ambientit të punës: 10 °C deri në 33 °C</p> <p>Bateri për regjistruar të temperaturës dhe njësia e kontrollit 12 V, 2,3 Ah bateri e ringarkueshme, e mbyllur dhe pa mirëmbajtje</p> <p>Alarmer (indikatore):</p> <p>Sistemi</p> <p>Modaliteti i ftohjes</p> <p>Temperatura e lartë</p> <p>Temperatura e ulët</p> <p>Dera e hapur</p> <p>Bateria e ulët</p> <p>Tundes i fikur</p>	
12	Shpelaresh gjaku	<p>Tensioni 230 V ± 10%, 50 Hz, AC</p> <p>Konsumi i energjisë Max 1100 Ë</p> <p>Temperatura e funksionimit 37 °C ± 0.2 °C</p> <p>Gama e temperaturës e programueshme 37 °C deri në 56 °C</p> <p>Gama e cilësimit të kohëmatësit 0 deri në 4 orë</p> <p>Alarmer dhe treguesit : Temperatura e lartë/e ulët , Alarm aukustik</p> <p>Ekran: LED</p> <p>Intervali i shfaqjes së temperaturës: 0,1 °C</p> <p>Kontrolluesi i temperaturës: Kontrollues dixhital i bazuar në mikroprocesor</p> <p>Kapaciteti: 12 qese (rreth 250 mL secila) plazma e rregullt /e freskët/ e ngrirë</p> <p>Koha e përpunimit Përafërsisht 40 minuta për qeset plazma të ruajtura në -30 °C</p> <p>Material çeliku inox të lëvizshëm në konfigurime 4 × 3 me ndarje individuale për ruajtjen e qeseve</p> <p>Mekanizmi i shkrirjes: Një dhomë e thellë shkrirjeje ruan temperaturën e ujit në 37 °C me një mekanizëm pompimi dhe një sistem ngrohjeje në linjë për të siguruar shkrirje uniforme. Një filtër pranë hyrjes së ujit brenda rezervuarit parandalon bllokimin dhe lëvizjen e pluhurit në pompë.</p> <p>Rezervuari i brendshëm Çelik inox</p> <p>Metoda e ndjeshmërisë së temperaturës: Sensori i mbyllur i zhytur direkt në ujë</p>	1
13	Shtreter portativ për sesion levizës	<p>Shtart Portativ I pershtashem për dhurim gjaku në terren. Mundesi për palosje për transport me të thjeshtë.</p>	3

14	Frigorifere per ruajtjen e gjakut +4 deri +6 grade	<ul style="list-style-type: none"> • Diapazoni temperatures (°C) +4 • Kapaciteti ne (L) 94 • Pesha 80-90 (KG) • Izolimi 50 -60 (mm) • Sonde PT1000 • Ekran LED min 4" me butona • Grafik temperature ne ekran • Mbrojtje me fjalekalim • Shkrirje automatike • Me ndricim te brendshem • Mbyullje dere me celes • Raftte te rregullueshme min 2 • Ngarkesa maksimale per raft 25-30 (kg) • Alarme vizuale dhe akustike • Alarm me tekst • Alarm temperature e larte/e ulet • Alarm per dere te hapur • Alarm per mosfunktionim sonde • Alarm per shkarkim baterie • Alarm per kompresorin • Bateri per alarmed deri ne 72 ore • Nr kompresorësh 2 • Materiali i brendshëm prej çeliku inoks • Materiali i jashtëm prej çeliku të veshur • Dimensione ËxDxH (mm) 50-60 cm x50-60 cm x75-85 cm 	2
15	Frigorifer ushqimor	Frigorifer I pershtatshem per ruajtjen e ushqimeve. Kapacitet jo me te vogel se 150 litra	1
16	Termus per transport gjaku	Kapaciteti mbajtes jo me pak se 3.7 litra Me mure te izoluara per ruajtjen e temperatures se brendshme. Teknologjia e ftohjes: Pasive	3
17	Peshore per dhuruesit	Peshore dixhitale per dhuruesit. Pesha maksimale jo me pak se 150kg. Ndarja jo me pak se 100gr.	2

Shenim: Per te gjitha materialet e siperpermenduara afati i garancise do te jete 1 (nje) vit nga momenti i Furnizimit.

Specifikimet teknike jane hartuar nga Specialist i fushes i emeruar me Urdherin nr. 2574 Prot. date 08.07.2022, te miratuara me shkresen me Nr. 2839 Prot. date 26.07.2022.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të

rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

NJESIA E PROKURIMIT

Aida Doko Armelin Çili Elona Dundo Kamela Halitaj Edlira Kostreni

MIRATOI

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ANILA KALA